



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni Parlamentar për Integrimin Europian

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2018”

Komisioni për Integrimin Europian (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 08 nëntor 2017, ne cilësinë e Komisionit *që jep mendim* mori në shqyrtim Projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2018” në parim.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit mori pjesë Z. Ditmir Bushati, Minister për Europen dhe Punët e Jashtme si dhe përqësues të Ministrisë së Financave

1. Qëllimi i projektligjit

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2018” parashikon tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore (buxheti i shtetit) e vendore (buxheti vendor) dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve) për vitin buxhetor 2018.

Projektbuxheti për vitin 2018 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për zbatimin e pesë reformave në sektorë kyç të ekonomisë: reforma e ujit, reforma në drejtësi, reforma në administratën publike, reforma e menaxhimit të financave publike dhe reforma administrative-territoriale të cilat, së bashku me reformat e tjera të ndërmarra, do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre. **Në planifikimin e investimeve publike për vitin 2018 janë mbajtur gjithashtu në konsideratë prioritetet e integrimit europian.**

Prioriteti i Qeverisë Shqiptare për vitin 2018 është hapja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Në kuadër të mbështetjes së procesit të integrimit të vendit në BE, projektbuxheti i vitit 2018, parashikon mbështetjen e veprimtarisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), përmes Programit Buxhetor “Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrimit”.

1. Plani Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2017-2020

Ky projektligj nuk është i parashikuar në PKJE 2017-2020, sepse kjo fushë nuk është e harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ajo mbetet kompetencë e vetë të Shteteve Anëtare të BE-së.

2. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

Legjislacioni parësor i BE-së

- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE): Nenet 313-316 dhe 320-324.

Legjislacioni dytësor i BE-së

- Rregullorja (BE, Euratom), Nr. 966/2012 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 25 Tetor 2012 “*Mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian, dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom), Nr 1605/2002*”, e ndryshuar”, Numri Celex 32012R0966, Fletore Zyrtare e BE-së, Seria L, Nr. 298, datë 26.10.2012, faqe 1 - 96.

Legjislacioni parësor (Nenet 313-316 dhe 320-324 të TFBE-së) dhe dytësor i BE-së (Rregullorja (BE), Nr.966/2012), përmban vetëm rregullat lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të Bashkimit Europian, por nuk parashikon rregulla lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së. Për pasojë, hartimi dhe miratimi i buxhetit nga Shtetet Anëtare të BE-së është kompetencë ekskluzive e këtyre shteteve, të cilat kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që ato i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

3. Përfundime

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2018” nuk përafron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të BE-së, por rregullon çështje të cilat i përkasin vetëm legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

Hartimi dhe miratimi i buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së nuk është i harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ato kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

Komisioni miratoi **në parim** me shumicë votash projektligjin në shqyrtim.

KRYETAR

GENC POLLO

